

GJL nr.1054/2012

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOMBEDITE KORRUPSIONIT AGENCIJA KOMBEDITE KORUPSIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dat.	DPK/DMP
Nr. Prot. B. Prot. M. Prot.	03-4112/12
Nr. E. N.	02
Ush. Duhim. Dat.	12.11.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesave të paraqitura nga Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë dhe nga i pandehuri Lulzim Rifaj nga Dragashi, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Dragash, Re.I.nr.636/12, të datës 14.08.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 28.09.2012 merr

AKTVENDIM

Ankesat e paraqitura janë të **BAZUARA**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Dragash, sipas aktvendimit Re.I.nr.636/12, të datës 14.08.2012, të pandehurin Lulzim Rifaj nga Dragashi, e ka shpallur përgjegjës sepse si zyrtar i lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31 mars të vitit 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësua dhe dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 17 pika 1/3 të Ligjit nr.04/L-050, në bazë të kësaj dispozite konform nenit 10 të LK-së, i ka shqiptuar dënimin me QORTIM.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë ka paraqitur ankesë për shkak të:

-vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesës pos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendim dhe i ka shqiptuar qortim të pandehurit duke aplikuar nenin 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet përkundër përgjegjësisë së lartë të të pandehurit për obligimin e deklarimit të pasurisë, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me ligjin nr.04/L-050 dhe me shqiptimin e qortimit ka rënë në kundërshtim me rregullat dhe zbutjen e dënimit të përcaktuar me nenin 9 të LK-së etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Lulzim Rifaj ka paraqitur ankesë për shkak të:

-shqiptimit të dënimit.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se aktvendimi i atakuar është i padrejtë, se kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj tij është e gabuar sepse Agjencioni nuk e ka njoftuar me kohë për obligimin e plotësimit të formularit për deklarimin e pasurisë. Më tutje thekson se vitin paraprak e ka deklaruar pasurinë dhe ka menduar që nga fakti se nuk ka patur ndryshme të pasurisë së tij edhe nuk ka obligim ta plotësoj formularin prapë etj. andaj propozon që ndaj tij të pezullohet procedura kundërvajtëse.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesat e paraqitura, aktvendimin e atakuar, deklaratën me shkrim të të pandehurit Lulzim Rifaj etj, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, ankesat e paraqitura nga Agjencioni kundër korrupsionit në Prishtinë dhe të pandehurit Lulzim Rifaj i aprovoi si të bazuara, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

2.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale kundërvajtëse dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

Shkeljet procedurale kanë të bëjnë me mosmarrjen në pyetje të të pandehurit para se të merret aktvendim, e sidomos duke pasur parasysh deklaratën me shkrim të pandehurit nga e cila rezulton se i pandehuri nuk është njoftuar dhe nuk ka pas në dispozicion formularin përkatës për deklarimin e pasurisë, gjithashtu nuk është marr në pyetje as ushtruesi i kërkesës i cili (bazuar në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse) pretendon që i pandehuri është njoftuar me kohë për obligimin e tij por të cilin nuk e ka përmbushur.

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me faktin se i pandehuri ka mohuar përgjegjësinë për kundërvajtje në rastin konkret, kurse gjykata, pa e administruar asnjë provë tjetër, e ka shpallur përgjegjës të pandehurin dhe i ka shqiptuar qortim.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë, duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të merr në pyetje të pandehurin eventualisht edhe ushtruesin e kërkesës, të administroj edhe prova tjera eventuale dhe më në fund varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Nga sa u tha më lartë, konform të nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL.nr.1054/2012, të datës 28.09.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Cunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Djalip Bega